



UNIVERSITETI BUJQËSOR I
TIRANËS

Nr. 3254 Prot.

Tiranë më, 12.11.2024



AKADEMIA E SHKENCAVE E
SHQIPËRISË

Nr. 1569/1 Prot.

Tiranë më, 21.11.2024

Protokoll bashkëpunimi
ndërmjet
Akademisë së Shkencave të Shqipërisë
dhe
Universitetit Bujqësor të Tiranës

Hyrje

- Mbështetur nenit 6, për *shkëmbimin e botimeve dhe informacionit*, të marrëveshjes dypalëshe në fuqi nënshkruar më datë 17.12.2020;
- Duke vlerësuar interesat e përbashkëta për katalogimin, përhapjen dhe shfrytëzimin *në linjë* të informacionit shkencor bazuar një gjuhë të njësuar të programimit digjital të tij;
- Referuar traditës së gjatë pozitive të bashkëpunimit të bibliotekave shkencore në kuadër të sistemit *Cobiss*, njëherësh edhe platformë dhe bazë të dhënash me akses të lirë për studiuesit dhe studentët;
- Duke konsideruar se marrëveshja e nënshkruar midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Institutit të Informacionit Shkencor IZUM, me qendër në Maribor (Slloveni), pronare intelektuale e sistemit dhe programit *Cobiss*, mbi bazën e së cilës pranë ASHSH është themeluar dhe funksionon *qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor (QKPISH)*, e akredituar prej si përfaqësuese dhe koordinuese për rrjetin e bibliotekave universitare e akademike në Shqipëri, *përbën një garanci juridike për respektimin e interesave të Palëve*,

ASHSH dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës nënshkruajnë këtë protokoll bashkëpunimi:

1. Përfaqësuese e Cobiss në Shqipëri është *Qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor* (QKPISH), që funksionon pranë ASHSH.
2. Rektorati i Universitetit Bujqësor të Tiranës, përfaqësuar nga Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU
3. *Palët* bien dakord të bashkëpunojnë për regjistrimin e kërkuesve të tyre shkencorë në bazën e të dhënave *E-cris.al*, që administrohet prej më shumë se një viti nga ASHSH, përmes QKPISH. Universiteti Bujqësor i Tiranës ofron të dhënat bazë të nevojshme për informim shkencor publik për profesoratin e çdo njësie. QKPISH për këto të dhëna ofron shërbim falas dhe të çdokohshëm për gjithë rrjetin universitar-akademik të vendit.
4. QKPISH siguron falas: mirëmbajtjen e rrjetit të sistemit *Cobiss* (*Cobiss.al*, *Cobib.al* dhe *E-cris.al*); përtëritjen e menjëhershme të sistemit me risitë e rrjetit; kualifikimin e stafit të bibliotekës, mbrojtjen e të dhënave dhe asistencë teknike e profesionale.
5. Universiteti Bujqësor i Tiranës paguan një kuotë mujore për anëtarësimin në rrjetin e përbashkët të informacionit *Cobiss.al* në masën 20 euro në muaj për çdo përdorues të njëkohshëm (bibliotekar/katalogues) të çdo biblioteke në varësi të tij. Pagesa bëhet në llogarinë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, IBAN: AL22202110130000000104030780, BIC: SGSBALTX, Raiffeisen Bank Tiranë.
6. Me nënshkrimin e këtij protokolli biblioteka e Universitetit Bujqësor të Tiranës fiton statusin e anëtarit me të drejta të plota në sistemin *Cobiss.al*.
7. Çështje të karakterit teknik dhe profesional të zbatimit të programit *Cobiss* dhe të shfrytëzimit të bazave të të dhënave *Cobiss.al*, *Cobib.al*, *E-cris.al* zgjidhen me anë të *Rregullores teknike për anëtarësimin dhe zbatimin praktik të programit "Cobiss"*, bashkëngjitur këtij protokolli.
8. Ky protokoll nënshkruhet në dy kopje, në gjuhën shqipe, një për secilën *Palë* me vlerë të barabartë.

Për Universitetin Bujqësor të
Tiranës
REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

Për Akademinë e Shkencave të
Shqipërisë



Konceptoi: K. Balliu
Pranoi: R. Bardhi

